



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 29 lidhur me nenin 40, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën 31.01.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e simbolit përkujtimor të gjenocidit në Kosovë

Neni 1

Me këtë vendim miratohet “Lulëkuqja me katër petale” të bëhet simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë.

Neni 2

Simboli “Lulëkuqja me katër petale” paraqet katër format e akteve gjenocide, që shteti i Serbisë, i bëri ndaj Kosovës dhe popullatës civile të Kosovës dhe ato janë si më poshtë:

- 2.1 Vrasjet
- 2.2 Dhunimi seksual
- 2.3 Spastrimi etnik i popullatës dhe
- 2.4 Djegie dhe shkatërrimi i objekteve që simbolizojnë përkatësinë etnike dhe identitetin shqiptar.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendim është simboli me emërtimin “Lulëkuqja me katër petale”

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-7408
Me datë 31.01.2023



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. Bexhet KUÇI